



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CA.nr. 2779/2017

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu Kryesues, Rafet Haxhaj e Hunaida Pasuli - anëtarë, (më tej kolegji) në kontestin e paditësit V.P., nga Podujeva, i përfaqësuar nga babai i tij N.P., të cilët i përfaqëson “Zyra Juridike Kompensimi në Prishtinë” I.R. dhe av. M.S., kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga D.H., për shpërblimin e dëmit jo material, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësueses të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, C.nr.287/2013 të 06.02.2017, në seancën e kolegjit, të mbajtur me dt. 08.01.2021, jep:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, C.nr.287/2013 i 06.02.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, me aktgjykimin C.nr.287/2013 të 06.02.2017, ka vendosur si vijon:

“Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësit V.P., nga Podujeva si e bazuar.

Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Byroja Kosovare e Sigurimeve” me seli në Prishtinë, t’ia paguan paditësit për aksidentin e dt.02.01.2012 si pasojë e lëndimeve të pësuarra dhe atë, në emër të kompensimit të dëmit material, shumën e përgjithshme prej 7.600,00 €, (shtatë mijë gjashtëqind Euro), e të gjitha këto me kamatë vjetore siç e paguajnë Bankat afariste në Republikën e Kosovës, kursimtarëve të vet, në mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dt. e marrjes së aktgjykimit dt. 06.02.2017, e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë:

Në emër të dëmit jo material:

Në emër të dhembjeve fizike shumën prej 2.200.00 €,

Për frikë të përjetuar, shumën prej 1.500,00 €,

Për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 12%, shumën prej 3.300 €,

Për shëmtim, shumën prej 600,00 €,

Përtej shumës së gjykuar, shuma prej 16.400,00 €, për paditësin V.P., nga Komuna e Podujevës, dhe kërkesat për përkuqdesje dhe ndihma e huaj, dhe për ushqim të përforcuar, refuzohen si të pa bazuara.

Detyrohet e paditura “Byroja Kosovare e Sigurimeve” me seli në Prishtinë, që paditësi t’ia kompensoj në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, shumën prej 927 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi;

Përtej shumës së gjykuar për paditësin V.P., për shpenzimet e procedurës kontestimore, refuzohen si të pa bazuara”.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura BKS me datën 23.02.2017, ka paraqitur një ankesë me të cilën ka kërkuar që aktgjykimi ankimor të ndryshohet, ashtu që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pathemeltë, ose i njëjti të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim, duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

Përgjigje në ankesë është paraqitur.

Kompetenca: Kolegji, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, e në bazë të shkresave në dosje, përfshirë edhe ankesën, vlerësoi se ka juridiksion për procedim dhe vendimmarrje në këtë çështje juridike, duke u bazuar në nenet: 22 e 23 të Ligjit për gjykatat, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 22/2018), si dhe neneve 190 e 194 të LPK.

Shqyrtimi i ankesës: Gjykata e shkallës së dytë duhet të shqyrtoj pranueshmërinë e ankesave, në raport me kërkesat ligjore të specifikuara me nenet 176, 178 e 186 të LPK, para se të vendosë për themelësinë e tyre.

Me vështrim në shkresat e lëndës (Fletë kthesat për dorëzimin e aktgjykimit të shkallës së parë si dhe zarfi për dorëzimin e ankesës në postë) rezulton se ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, është e lejueshme sepse është paraqitur nga personi që ka interes juridik, ndërsa paraprakisht nuk është hequr dorë nga e drejta në ankim, kurse ankesa e paraqitur nuk është tërhequr deri në ditën e vendim marrjes.

Ankesa e paraqitur përmban elementet e përcaktuara me ligj, pra ajo është e plotë.

Kolegji, vlerëson se ankesa i përmbush kërkesat ligjore nga nenet 176,178 lidhur me nenin 186 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 38/08), i datës 20 shtator 2008, i cili ka hyrë në fuqi me 6 tetor 2008 (më tej LPK).

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në bazë të nenit 194, të LPK e ekzaminoj aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore, dhe gjeti së:

Ankesa është e pa themeltë.

Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë, gjatë zbatimit të procedurës në këtë çështje kontestimore, nuk ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave ligjore nga neni 182.2 b), g), j) k) dhe m) të LPK, për të cilat gjykata e shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nga shkresat në lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë kishte bërë shqyrtimin kryesor të çështjes, kishte marrë provat e përshkruara në procesverbalin e seancave përkatëse dhe kishte konstatuar gjendjen faktike të përmbajtur në arsyetimin e aktgjykimit ankimor si vijon:

Se me datën 02.01.2012, në rrugën “...” në Podujevë, kishte ndodhur një aksident komunikacioni i shkaktuar me fajin e personit NN, i cili ditën kritike e drejtonte automjetin NN. Drejtuesi i automjetit është i panjohur si dhe vetura me të cilën është shkaktuar ngjarja aksidentale, ishte e paidentifikuar NN.

Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi kishte pësuar lëndime të rënda trupore, si pasojë e të cilave ka përjetuar dhembje fizike dhe frikë, në kohëzgjatje dhe intensitet të caktuar nga mjekët ekspert, si dhe shëmtim trupor të shkallës së lehtë.

E paditura në përgjigje në padi, dhe në seancat gjyqësore, e kishte kontestuar bazën e kërkesëpadiisë, duke pohuar se në këtë rast paditësi e kishte paraqitur padinë, pas skadimit të afatit ligjor të paraparë me nenin 20 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia.

Në bazë të kësaj gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë, kishte vlerësuar se janë përmbush kërkesat ligjore nga nenet 172, e 183 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve si dhe nenit 323 të LPK, ndërsa vendimi për kamatëvonesën është caktuar sipas dispozitave të nenit 378 të LMD dhe rrjedhë nga momenti i ditës së dhënies së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë.

Pretendimet ankimore: Përfaqësuesi i të paditurës në ankesë ka pohuar se aktgjykimi ankimor është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2, e), n) dhe o) të LPK, sepse dispozitivi është i pakuptueshëm si dhe kontradiktor me vet vete dhe me arsyetimin e tij. Arsyetimi nuk përmban dispozitat ligjore të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, si dhe faktet lidhur me përgjegjësinë e të paditurës.

Shkelja e dispozitës ligjore të nenit 182.2 e) të LPK, konsiston në faktin se paditësi, padinë e ka paraqitur pas skadimit të afatit ligjor të parapara me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia

Në këtë rast, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike, sepse nuk ka prova lidhur me rrjedhën e procedurës penale, se a, ashtë identifikuar shkaktari i aksidentit, me tej e paditura në ankesë ka pohuar se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale në dëm të paditurës, sepse arsyetimi i aktgjykimit nuk përmban strukturën ligjore të parapara me nenin 160.5 të LPK, lidhur me zbatimin e të drejtës materiale.

Me asnjë dispozitë ligjore, nuk është përcaktuar se e paditura BKS, është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar në ngjarjen aksidentale, nga personi i pidentifikuar NN.

Pala paditëse pa të drejtë, ka paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë, pa kërkuar paraprakisht nga tani e paditura, realizimin e shpërblimit të dëmit, ashtu që pa të drejtë të paditurës i janë shkaktuar shpenzime procedurale.

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe plotësisht ka konstatuar gjendjen faktike, kur ka vlerësuar se në rastin konkret, se paditësi V.P., në cilësi të udhëtarit, me

dt.02.01.2012, në rrugën “...” në Podujevë, si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga personi NN, me veturën NN, kishte pësuar lëndime të rënda trupore, dhembje fizike, frikë dhe shëmtim trupor.

Ndaj personit NN, ishte paraqitur kallëzim penal, nga Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor, me numër zyrtar ..., dt.02.01.2012.

Gjykata e shkallës së parë, kishte marrë mendimin e mjekëve ekspert kompetente, si dhe mendimit të ekspertit të komunikacionit dhe kishte vlerësuar se ngjarja aksidentale ditën kritike ishte shkaktuar me lëshimet e drejtuesit NN, të veturës së pa identifikuar NN.

Me nenin 20 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia i publikuar në (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.4 të dt. 14.07.2011, është përcaktuar:

“Dëmshpërblimi nga përdorimi i mjeteve të paidentifikuara 1. Personi fizik i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi nga përdorimi i mjetit motorik të paidentifikuar, ka të drejtë të parashtrojë kërkesën për dëmshpërblim Byrosë.

2. Personi fizik i dëmtuar ka të drejtë dëmshpërblimi për dëmet që vijnë si rezultat i vdekjes, dëmtimeve trupore apo përkeqësimit të shëndetit deri në shumën e përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji.

5. Në rast të identifikimit të mëvonshëm të mjetit shkaktar të aksidentit, apo të siguresit përgjegjës, Byroja ka të drejtë regresi nga personi përgjegjës ose siguresi përgjegjës për shumën e paguar të dëmit, shpenzimet dhe kamatat.”

Andaj, kolegji vlerëson se legjitimiteti pasiv i të paditurës, në këtë rast, është i bazuar në paragrafin 1 të Ligjit të lartë cituar, sepse në rastin konkret paditësi, në cilësi të udhëtarit, ka pësuar dëm nga automjeti i paidentifikuar, kurse gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se dëmi është shkaktuar me fajin e drejtuesit të automjetit të paidentifikuar, e që sipas bazës ligjore të paragrafit 3 të Ligjit të lartë cituar, ai ka të drejtë në shpërblimin e dëmit, kurse e paditura ka detyrim ligjor shpërblimin e dëmit ndaj të dëmtuarit.

Në rast të identifikimit të mëvonshëm të mjetit shkaktar të aksidentit, apo të siguresit përgjegjës, Byroja ka të drejtë regresi nga personi përgjegjës ose siguresi përgjegjës për shumën e paguar të dëmit, shpenzimet dhe kamatat.

Kolegji, konkludon se procedura kontestimore është e pavarur nga zhvillimi i procedurës penale, në kontestet për shpërblimin e dëmit, me përjashtim, kur për ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të kryerësit, çështja ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë të dhënë në procedurë penale, me të cilën i pandehuri është shpallur fajtor.

Në rast të ekzistimit të aktgjykimit të formës së prerë, të dhanë në procedurë penale, me të cilën është konstatuar ekzistimi i veprës penale si dhe përgjegjësia penale e kryerësit, atëherë në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 14 të LPK, gjykata në procedurë kontestimore, është e lidhur me aktgjykimin penal të formës së prerë.

Pretendimi ankimor, i të paditurës se paditësi në këtë rast padinë në gjykatë, e ka paraqitur pas skadimit të afatit ligjor, të paraparë me nenin 20.4 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, është i pathemeltë, sepse me këtë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar afati ligjor për paraqitjen e padisë e as nuk janë paraparë pasoja ligjore nëse i dëmtuari nuk e paraqet rastin në afat prej 90 ditësh të tani e paditura.

Praktika gjyqësore, është e zhvilluar në këtë drejtim dhe në asnjë rast, padia e paditësit, në rastet e kësaj natyre nuk është hedhur poshtë, për shkak të kërkesave ligjore të nenit 20.4 të Ligjit të lartë cituar.

Pretendimi tjetër ankimor i të paditurës, se fillimi i procedurës kontestimore, pa zbatuar paraprakisht kërkesat ligjore të nenit 20 të Ligjit të lartë cituar, është i pathemeltë, sepse e paditura në çdo kohë ka pas mundësi që me palën paditëse të lidh pajtim jashtë gjyqësore ose gjyqësor në përputhje me dispozitat ligjore.

E paditura, në këtë kontest, duke filluar nga përgjigja në padi, e ka kontestuar themelësinë e kërkesëpadisë, e që rezulton se ka ndikuar në shkaktimin e shpenzimeve procedurale, me marrjen e mendimit të ekspertëve kompetent, nga lëmi i mjekësisë dhe komunikacionit, zhvillimin e seancave gjyqësore, e që e ka rezultuar, me krijimin e shpenzimeve të nevojshme për zhvillimin e procedurës kontestimore.

Me nenin 1057 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr.04/L-077 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.16/19 i dt.19.06.2012), i cili konsiderohet se ka hyrë në fuqi nga data 20 dhjetor 2012, është përcaktuar: *“Dispozitat e këtij ligji, nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji”*.

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në këtë rast, gabimisht është thirr në zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-077, sepse në kohën e shkaktimit të dëmit (me dt.02.01.2012) ky ligj nuk ishte në fuqi, por në zbatim ishte Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (“Gazeta zyrtare e ish RSFJ” nr.29/78 si dhe Ndryshim Plotësimet e tij).

Lartësia e shumave të gjykuara, nga gjykata e shkallës së parë, për shpërblimin e dëmit, jo material të cilën është obliguar e paditura t’ia paguaj paditësit, e paditura nuk i ka kontestuar.

Kolegji, duke u kujdesuar sipas detyrës zyrtare, për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë rast, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, nenet 200 e 277 të LMD së vitit 1978, pasi që në rastin konkret janë përmbush të gjitha kërkesat ligjore për përgjegjësinë juridiko-civile, lidhur me shpërblimin e dëmit nga auto përgjegjësia, me automjet të pa identifikuar.

Pretendimet ankimore, të paditurës ishin të pathemelta, sepse ajo deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes, nuk provoi se kërkesëpadia e paditësit është e pa themeltë, edhe përkundër faktit se e kishte barrën e provës.

Më sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë krijuar kushtet ligjore nga neni 200 i LPK, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CA nr. 2779/2017 dt. 08.01.2021

Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari

Gani Avdiu